

## Link-KONTRATA

### Lidhja e Kontratës

Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike çdo person:

- jo debitor ndaj furnizuesit universal,
- ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe
- ploteson kërkesat e përcaktuara në ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike.
- çdo klient i cili ka përfituar statusin e “klientit në nevojë” , sipas përcaktimeve të nenit 95 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe që është rregjistruar pranë OSHEE si i tillë.

### Procedura per lidhjen e kontrates

Klienti fundor që kërkon lidhjen e kontratës me furnizuesin e ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit duhet të depozitojë:

Një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në këtë kontratë.

Furnizuesi kontrollon dhe verifikon të gjithë dokumentacionin e kërkuar,

Nënshkruan kontratën me Klientin brenda 15 diteve kalendarike, nga marrja e kërkesës së aplikuesit.

Furnizuesi brenda 7 ditësh kalendarike, do të njoftojë me shkrim, aplikuesin për mangësitë e konstatuara ne dokumentacion.

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 7 ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit ne te kundert kerkesa refuzohet.

Furnizuesi njofton me shkrim aplikuesin, në adresën e përcaktuar nga aplikuesi në kërkesën për furnizim, në çdo ras për pranimin ose jo të kërkesës së tij.